



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË MITROVICË



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, për periudhën kohore Tetor - Dhjetor 2024.

Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë



Mitrovicë, 07 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, në periudhën 30 shtator – 06 tetor 2024, ka regjistruar gjithsej dyzeteshtatë (47) kallëzime penale, ndaj pesëdhjetetë (58) personave, për vepra të ndryshme penale.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- Njëzetënëntë (29) aktakuza, ndaj tridhjetënëntë (39) personave,
- Trembëdhjetë (13) persona të ndaluar,
- Tetë (8) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj nëntë (9) personave,
- Një (1) kërkesë për caktimin e arrestit shtëpiak ndaj katër (4) persona,

Takimet e ndryshme të realizuara:

- UD/Kryeprokurori Njazi Rexha ka realizuar takimet e hapura me qytetarë,
- UD/Kryeprokurori Njazi Rexha ka realizuar takime të ndryshme me UNMIK dhe EULEX,

Arrestohet në Zveçan një person për armëmbajtje pa leje dhe sekuestrohet një sasi armatimi




Mitrovicë, 09 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, njofton opinionin se është arrestuar në Zveçan një person me initiale R.J., për shkak të dyshimit të bazuar mirë për kryerjen e veprës penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Të njëjtit, gjatë kontrollit në shtëpinë e tij i janë gjetur dhe sekuestruar një (1) pushkë karabinë, një (1) pushkë gjuetie, një (1) pushkë ajrore, plumba të pushkës ajrore, gëzhoja të zbrazëta nga pushka e gjuetisë, xhaketë ushtarake me emblemë Republika e Serbisë, fitil eksplozivi pa ndezës, dhe rreth njëqind (100) gramë barut.

I dyshuari, me vendim të prokurorit është dërguar në mbajtje për 48 orësh.


Aktakuzë kundër tre personave për cenim të drejtave të punësimit dhe papunësisë në Ndërmarrjen Trepça SH.A



Mitrovicë, 16 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, kundër të pandehurve A.H., E.M., dhe B.A., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë”, nga neni 219 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Të pandehurit, në janar të vitit 2020, si anëtar të komisionit për pranimin e punëtorëve të minierën e Trepça SH.A., në bashkëkryerje dhe me dashje kanë vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke mos përfillur procedurat e rekrutimit të përcaktuara sipas udhëzimit administrativ të MPMS lidhur me rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.



Të njëjtit, kanë shkelur rregulloren e vlerësimit gjatë intervistimit me gojë të kandidatëve, ashtu që në vend të vlerësimit për çdo pyetje të saktë me njëzet (20) pikë siç rregullohet në udhëzim administrativ, në rastin konkret të pandehurit i kanë vlerësuar kandidatët me nga njëzetepesë (25) pikë për pyetje në total me mbi njëqind (100) deri treqind (300) pikë, duke i sistemuar në vende pune dhe themeluar marrëdhënie të punës me shtatë (7) persona, dhe me këtë veprim kandidatëve tjerë u ka mohuar të drejtën për punësim dhe kushte të njëjta ashtu siç parashihet me ligj.

Me këto veprime, të pandehurit A.H., E.M., dhe B.A., kanë kryer veprën penale e cila u vihen në barrë.

Prokurori i Shtetit, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shpallë fajtor për veprën e kryer penale dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Aktakuzë kundër dy personave për keqpërdorim detyre apo autoriteti zyrtar dhe legalizimi të përmbajtjes së rreme

Mitrovicë, 18 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, kundër të pandehurit H.Rr., për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK, si dhe kundër të pandehurit L.V., për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale “Legalizimi i përmbajtjes së rreme” nga neni 403 paragrafi 1 Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)

I pandehur H.R., akuzohet se në katër (4) raste në vitet 2016-2017, në cilësinë e personit zyrtar – zyrtar i gjendjes civile në komunën e Vushtrrisë, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo personave tjerë, si dhe shkeljes së drejtave të personave tjerë, ka shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tij zyrtar, ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare, në atë mënyrë që në kundërshtim me Ligjin për gjendjen civile nr.04/L-003, Ligjit për shtetësinë e Kosovës dhe udhëzimet administrative ka regjistruar në sistemin elektronik të gjendjes civile katër (4) persona, me të dhëna fiktive, pa qenë të regjistruar në librat amëz të lindjes, dhe kështu i ka pajisur kundërligjshëm me numër personal dhe dokumentacion.

I pandehuri L.V., akuzohet se me datë 19 qershor 2017, në zyrën e regjistrimit civil, i njëjti ka vënë në lajthim organin kompetent – zyrën e regjistrimit civil në komunën e Vushtrrisë dhe ka vërtetuar një çështje të pa vërtetë në atë mënyrë që pa qenë i regjistruar në librat amëz të lindjes në gjendjen civile, me dokument të falsifikuar ka arritur të regjistrohet dhe të marrë numrin personal dhe të pajiset me dokumentacion.

Me këto veprime, të pandehurit H.Rr., dhe L.V., kanë kryer veprën penale e cila u vihen në barrë.

Prokurori i Shtetit, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shpallë fajtor për veprat e kryer penale dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Prokuroria Themelore e Mitrovicës dhe policia ushtrojnë urdhër kontrole nëpër shkollat e mesme të Mitrovicës



Mitrovicë, 05 nëntor 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, në bazë të urdhëresës së lëshuar nga Gjykata kompetente, gjatë dy ditëve me 04 dhe 05 nëntor kanë ushtruar urdhër kontroll nëpër të gjithë shkollat e mesme të Mitrovicës.

Zbatimi i këtij urdhër kontrolli ka qenë në kuadër të veprimeve dhe masave parandaluese për ofrimin e sigurisë në shkolla.

Prokurori i shtetit dhe policia mbeten të përkushtuar që edhe në të ardhmen të zbatojnë urdhër kontrole të tilla, me qëllim të ofrimit të së sigurisë nëpër shkolla si dhe parandalimit të dukurive negative.